

Newsletter Bota e SIGAL UNIQA

Bashkohu me ekipin më të mirë

Sigurimi nga aksidentet të sportistëve
vetëm tek SIGAL UNIQA

SIGAL UNIQA
mbështetës
krenar i
Kombëtares



Ja ku takohemi sërish me "Bota e SIGAL UNIQA" me zhvillimet kryesore të Grupit për muajin Nëntor. Një muaj i mbushur me aktivitete dhe zhvillime motivuese për të ardhmen në të trija shtete të grupit: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë. Por pa harruar edhe kompaninë mëmë, "UNIQA Insurance Group", me seli në Vjenë.
Lexim të këndshëm

PËRMBAJTJA

INr.1 i sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA mes “Top 50” më të mëdhenjve në Evropën JugLindore	2
"Prespektivë e qëndrueshme"/ Standard & Poor's konfirmon vlerësimin me "A" për UNIQA-n	3
UNIQA Insurance Group / UNIQA në rritje të qëndrueshme financiare për 9-mujorin 2023	4
Tregu i sigurimeve në Shqipëri për 10-mujorin 2023/ Grupi “SIGAL UNIQA” ruan leadershipin. I pari edhe në dëmet e paguara	5
SIGAL UNIQA, lider i Sigurimeve edhe në Kosovë	6
UNIQA mbetet zgjedhja e parë e të siguruarve!	6
“Takohemi te SIGAL”/ Godina simbol në zemër të Tiranës që vijon të mbetet një pikë referimi për qytetarët	7
“Stina e përmbytjeve”/ Sigurimi i Pronës dhe KASKO, varkat e vetme të shpëtimit	9
“Këngët Çlirimtare” pushtojnë Muzeun Kombëtar/ Orkestra e Harqeve SIGAL UNIQA, koncert me rastin e 79-vjetorit të Çlirimit të Tiranës	11
SIGAL Audiobooks.al iu ribashkua Panairit të 26-të të Librit ...	12
Vetëm 1 në 35 mijë ka një pension privat/ Ponari: Do të duhej të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues	14
Jo thjesht një kompani sigurimesh/ ‘UNIQA’ vijon traditën, dorëzon çekun për “Caritas Austria”	16

“Jetojmë më mirë së bashku nuk duhet të mbesë thjesht një premtim, por të jetë e mbushur me veprime. Ajo është motoja mbi të cilën punojmë çdo ditë, duke u përpjekur të jemi sa më pranë klientëve tanë por edhe komunitetit ku operojmë”

Avni Ponari, CEO i Grupit “SIGAL UNIQA”, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.

SIGAL UNIQA, mes ‘Top 50’ kompanive më të mëdha të sigurimit në Evropën Juglindore

Kompania e sigurimeve “SIGAL UNIQA Group Austria”, nuk është thjesht më e madhja dhe më e besuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Kompania e themeluar në vitin 1999 dhe pjesë e “UNIQA Insurance Group” është edhe një ndër më të mëdhatë në Evropën Juglindore.

Sipas “Top SEE 100 Insurers”, publikuar nga “See News”, SIGAL UNIQA, e cila gjatë vitit 2021 rënditej në vendin e 51, është rritur me 3 pozicione për vitin 2022 duke hyrë në Top 50 (vendi 48).

Grupi “SIGAL UNIQA” ka shënuar rritje jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova renditet në vendin e 92-të nga vendi i 98-të (2021), ndërsa UNIQA në Maqedoninë e Veriut është në pozitën e 85-të, duke u përmirësuar me dy pozicione krahasuar me një vit më parë.

Sipas CEO-s së Grupit, z.Avni Ponari, viti 2022, edhe pse i vështirë për shkak të luftës në Ukrainë dhe pasojave që vijnë të ndihen nga pandemia “COVID-19”, ka qenë i suksesshëm për SIGAL UNIQA Group Austria-n.

“Viti 2022 nuk ka qenë shumë i lehtë. Pasojat e pandemisë botërore COVID-19 vijnë ende të kenë ndikim, sulmi rus në Ukrainë ka pësuar ulje

dhe ngritje të shpeshta, duke na e bërë jetën jo fort të sigurt.

Por pavarësisht këtyre, 2022 ishte edhe një vit që na dha përparësi në udhëkryqe të reja, që na drejtojnë në rrugëtime të cilat nuk i kemi hasur më parë. Baza jonë solide dhe elastike e ka bërë ‘SIGAL UNIQA Group Austria’ lehtësisht të adaptueshëm në situata të panjohura dhe të thjeshtë për të reaguar shpejt në situata në ndryshim”, shprehet ai.

“Top SEE 100 Insurers” është një renditje vjetore e kompanive më të mëdha në Evropën Juglindore, sipas të ardhurave totale për vitin 2022. Ajo mbulon kompanitë financiare të regjistruara në Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Moldavi, Mali i Zi, Rumani, Serbi dhe Slloveni.





Prespektivë e
qëndrueshme

Standard & Poor's konfirmon vlerësimin me "A" për UNIQA-n

Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit, me seli në New York, Standard & Poor's (S&P) i jep UNIQA INSURANCE Group, pjesë e së cilës është edhe "SIGAL UNIQA Group Austria", vlerësimin më të mirë të mundshëm.

"Për mendimin tonë, Grupi do të vazhdojë të përdorë marrëdhëniet e tij të gjata me klientët privatë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bashkëpunimet bankare për të forcuar më tej pozicionin e tij në treg në Austri dhe Evropën Qëndrore dhe Juglindore," shkruajnë analistët.

Ekspertët e agjencisë së vlerësimit identifikojnë qasjen e orientuar drejt klientit dhe bashkëpunimin me bankat (kryesisht Raiffeisen) që shesin produkte sigurimesh (bankassurance) si arsyt kryesore për konkurrencën e Grupit.

Integrim i suksesshëm

"S&P" përmend gjithashtu integrimin e suksesshëm të kompanive AXA, duke përmirësuar më tej pozitën e UNIQA në Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovaki. Analistët presin që ky trend të vazhdojë duke pritur rezultate dhe kapitalizim më të fortë.

Prandaj, agjencia e vlerësimit pret që UNIQA të ruajë fitimin e saj në 2023-2025, pavarësisht sfidave gjeopolitike dhe makroekonomike.

Sipas "S&P", UNIQA ka krijuar një pozicion të mirëpërcaktuar në treg dhe një portofol të gjerë dhe të larmishëm produktesh, në tregun austriak dhe evropian të sigurimeve përmes një strategjie të fokusuar te rritja organike.

"Ne presim që Grupi të vazhdojë të zgjerohet, me sukses në 2023-2025, i nxitur nga rritja organike e njësive të Evropës Qendrore dhe Juglindore, efektet e vazhdueshme të sinergjisë dhe një biznes bazë të qëndrueshëm në Austri."

Që prej 23 mars 2007 SIGAL është pjesë e grupit të madh financiar "UNIQA Insurance Group", i cili zotëron rreth 87% të aksioneve të kompanisë.

24 mijë punonjës, të cilët u shërbejnë mbi 16 milionë klientëve në 17 shtete të ndryshme, e bëjnë "UNIQA Insurance Group" një prej gjigandëve të sigurimeve në Europë dhe jo vetëm.

Me një histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve, UNIQA numëron rreth 7 miliardë euro prime në vit duke u rënditur mes emrave më të mëdhenj të sigurimeve në kontinent.

Nën moton "Jetojmë më mirë së bashku", "UNIQA Insurance Group" punon çdo ditë përmes 40 kompanive të saj të kthejë këtë biznes nga një ofrues i produkteve të sigurimit në një ofrues shërbimi të integruar që mbledh klientët e tyre aty ku ata qëndrojnë në "mjedisin e nevojave" të tyre individuale.

Në këtë frymë, "UNIQA Insurance Group" solli për herë të parë në Shqipëri përmes SIGAL, Sigurimin Privat të Shëndetit ndërsa sot kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, me mbi 1 milion klientë, ofron shërbime inovatore për vendin dhe jo vetëm siç janë: "TeleShëndet", "Jetë Plus", Asistenca Rrugore "SIGAL UNIQA AutoSOS" dhe së fundmi "Sigurimi anti-Tumor".



“UNIQA”, shifra impresionuese gjatë 9-mujorit 2023

Brandstetter: Miliona euro investime në spitalet private të Grupit

Grupi i Sigurimeve “UNIQA” regjistron shifra impresionuese gjatë 9-mujorit 2023.

Kompania austriake, prezente edhe në Shqipëri dhe rajon përmes SIGAL UNIQA Group Austria, gjatë periudhës janar-shtator 2023, shënon rritje në prime prej 9.4% ose 5.5 miliardë euro, në rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

“Pavarësisht dëmeve në rritje, për shkak të fatkeqësive natyrore, veçanërisht në periudhën e verës në Austri, kemi arritur të përmirësojmë ndjeshëm rezultatet tona. Rritja në rentabilitet, e nxitur kryesisht nga kompanitë tona në Evropën Qendrore dhe Juglindore, na mundëson të vazhdojmë të investojmë në fushën e shëndetit.

Përveç investimit prej 65 milionë eurosh në zgjerimin dhe modernizimin e Spitalit Privat Döbling, po investojmë edhe 180 milionë euro në ndërtimin e spitaleve të reja private, Confraternität dhe Goldenes Kreuz në Vjenë.

Ne po vendosim standarde të reja të kujdesit shëndetësor në spitalet private të Grupit “PremiQaMed”, shprehet ndër të tjera CEO i Grupit, Andreas Brandstetter.

Të dhënat kryesore për 9-mujor 2023

Sigurimi i Pronës

Primet e shkruara në sigurimin e pronës u rritën me 14.4% duke arritur në mbi 3,2 miliardë euro (janar- shtator 2022: 2,830.0 milionë euro).

Sigurimi i Shëndetit

Në sigurimin e shëndetit, u regjistrua një rritje në primet e shkruara prej 8.2% duke arritur në mbi 1 miliard euro (janar- shtator 2022: 962.5 milionë euro).

KUSH ËSHTË UNIQA

“UNIQA Insurance Group” daton prej vitit të largët 1811 kur u themelua “Salzburger Landes-Versicherung”. Ndërsa sot, kompania mban emrin e saj në rangun e lartë të industrisë së sigurimeve, me një shtrirje në 17 shtete ku operon përmes 40 kompanive.

Sipas studimeve të pavarura, “UNIQA Insurance Group” është prej shumë vitesh marka më e njohur dhe më e besueshme e sigurimeve në Austri.

Ajo numëron rreth 22,400 punonjës, mbi 16 milionë klientë “UNIQA Insurance Group”, i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve

“UNIQA Insurance Group” ishte i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve. Që prej 23 mars 2007, kompania austriake zotëron rreth 87% të aksioneve të kompanisë së parë shqiptare të sigurimeve, SIGAL

Tregu i sigurimeve në Shqipëri për 10-mujorin 2023

Grupi “SIGAL UNIQA” ruan lidershipin. I pari edhe në dëmet e paguara.




Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare publikon raportin mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri për 10-mujorin 2023.

Sipas AMF, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar-tetor 2023 kapën vlerën 18,838 milionë lekë, ose 9.64% më shumë se në janar-tetor 2022. Gjatë muajit janar-tetor 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,211,966 me një rritje prej 11.22% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.94% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.00% dhe risigurimi 0.065%.


Sa i përket 8 kompanive që operojnë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet më e madhja në Shqipëri, si për pjesën që ze në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët.

NDARJA E TREGUT DHE DËMET E PAGUARA



Edhe sa i përket Sigurimit të Jetës, SIGAL LIFE UNIQA Group Austria mbetet në krye të tregut ku operojnë 4 kompani.

NDARJA E TREGUT DHE DËMET E PAGUARA



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

SIGAL UNIQA Group Austria është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

E themeluar në shkurt 1999, SIGAL UNIQA operon suksesshëm në të trija shtetet përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurime Jo-Jetë, 3 Sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Që prej marit 2007, SIGAL UNIQA është pjesë e “UNIQA Insurance Group”, një prej emrave më të njohur të sigurimeve dhe financave në Austri dhe Evropë, e shtrirë në 17 shtete të ndryshme. “UNIQA” numëron mbi 16 milionë klientë ndërsa është vlerësuar nga “Standard & Poor’s” me “A”.

Portofoli i SIGAL UNIQA Group Austria është i risiguruar në tregjet më të mëdha botërore teksa kompania bashkëpunon me emra të mëdhenj si: UNIQA Re, Munich Re apo Hannover Re duke ofruar një garanci më shumë për mbi 1.2 milion klientët e saj.

Ritmet e progresit të SIGAL UNIQA kanë bërë që shumë publikime profesionale në fushën e sigurimeve ta vlerësojnë atë me shumë çmime.


Së fundmi ishte “See News”, e cila e rëndiste atë mes Top 50 kompanive më të mëdha të sigurimeve në Evropën Juglindore.

SIGAL UNIQA, lider i Sigurimeve edhe në Kosovë

Të dhënat më të reja të tregut të sigurimeve për 9-mujorin e parë të vitit 2023.

Në këtë periudhë, SIGAL UNIQA vazhdon të qëndrojë në pozitën e liderit në tregun e Kosovës, duke shënuar një volum të jashtëzakonshëm prej 14,517,148 eurosh në premiume!

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.



UNIQA Maqedoni e Veriut mbetet zgjedhja e parë e të siguruarve!


Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve - AMS-ja, UNIQA SHA Shkup ka shënuar Bruto Prim të Shkruar më të lartë për muajin tetor 2023 në të gjithë industrinë e sigurimeve.

Suksesi i arritur është rezultat i besueshmërisë dhe shërbimit afatgjatë që marrin klientët kur zgjedhin UNIQA si partner financiar.

UNIQA - Jetojmë më mirë së bashku

Më shumë informacion mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:

<https://aso.mk/.../izveshtai-za.../drushtva-za-osiguruva-e/>



jetojmë më mirë së bashku

Rajonal dhe Ndërkombërt
Partneri juaj në sigurime

“Takohemi te SIGAL”/ Godina simbol në zemër të Tiranës që vijon të mbetet një pikë referimi për qytetarët

Një ndërtesë e ndërtuar në vitin 1962, e cila i ka rezistuar viteve dhe mbetet edhe sot, pas 61 vjetësh, mbetet një nga godinat simbol të kryeqytetit. E pozicionuar në zemër të Tiranës, sot ajo është ndërtesa ku ushtron aktivitetin kompania më e madhe e sigurimeve në vend, “SIGAL UNIQA Group Austria”, ndërsa mbetet një pikë referimi për qytetarët që jetojnë dhe vijnë në Tiranë. Ndaj, shumëkush prej nesh e ka dëgjuar fjalinë “Takohemi te SIGALI”.

Por çfarë ka qenë para viteve '90 ndërtesa e famshme pas “15 Katëshit”?

Qytetarët e vjetër të kryeqytetit e dinë se aty ngrihej “Hotel Peza”, ndërsa pas viteve '90 do të kthehej në një qendër të rëndësishme biznesi, fillimisht “Veve Business Center” e më pas “SIGAL Business Center”.

Godina ku operon kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon

Sot, në këtë godinë ushtron aktivitetin e saj kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria, e cila operon në këtë sektor që prej shkurtit 1999.

Një kompani që nisi me vetëm 5 persona, 1 zyrë të vogël në Bulevardin “Zogu i Parë” dhe një kapital prej vetëm 400 mijë dollarësh. Ndërsa sot kryeson tregun, është në avantgardë me kompanitë simotra dhe numëron mbi 1,2 milion klientë, mbi 2400 punonjës e agjentë dhe mbi 1200 zyra.


Boom-i i ndërtimeve

Pavarësisht “joshjeve” të kohës e interesit të lartë për të ndërtuar në zonën më të shtrenjtë të Tiranës, themeluesit e SIGAL UNIQA Group Austria nuk janë tunduar duke u bërë kështu shkak për të ruajtur një prej ndërtimeve simbol e që mbart për çdo qytetar tiranas kujtime pafund. Tirana po ndryshon ditë pas dite. Ajo po njeh transformime të vazhdueshme, që lidhen me nevojat e zhvillimit dhe sot kryeqyteti i shqiptarëve është njësoj simotrat e tij në Europë.

Por zhvillimi nuk duhet të çënojë identitetin e qytetit, dëshmitë e tij të rëndësishme historike dhe kulturore.

“E çfarë është historia? Një jehonë e së kaluarës në të ardhmen; një pasqyrim i së ardhmes në të shkuarën”, do të shprehej shkrimtari i madh francez Viktor Hygo.


Marrë nga sigal.com.al



Blije online
sigal.com.al

Zgjidhni Shqipërinë për pushimet tuaja

Shmangni radhën në pikat kufitare dhe mbërrini më shpejt te familjarët tuaj në Shqipëri me “Policën Kufitare”



“Stina e përmbytjeve” / Top News: Sigurimi i Pronës dhe KASKO nga SIGAL UNIQA, varkat e vetme të shpëtimit

Njeriu bashkëjeton me rrezikun. Tërmeti, zjarret, përmbytjet godasin herë pas here në komunitete të gjera dhe kohë të ndryshme. Dhe goditjet përkthehen me një emërues të përbashkët të quajtur katastrofë.

Shqipëria është shteti më i rrezikuar në Europë nga katastrofat natyrore. Të paktën 30 mijë persona në vit janë prekur prej tyre që prej vitit 1995 duke bërë që rreziku nga fatkeqësitë natyrore të jetë i lartë.

Këto goditje, sipas Bankës Botërore, e kanë vendosur vendin tonë me rreth të kuq, me probabilitet të lartë risku, 8.46 nga 10 që është koeficienti maksimal.

Por pavarësisht këtij risku permanent, shqiptarët vijnë të qëndrojnë të pasiguruar.

Nga të dhënat zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare rezulton se për periudhën janar-shtator janë paguar më pak se 20 milionë euro në gjithë vendin për sigurimin e pronave nga fatkeqësitë natyrore.

Por kompanitë e sigurimeve në Shqipëri, aktive në treg prej shumë vitesh dhe solide nga ana financiare, ofrojnë për qytetarët dhe bizneset produkte Sigurimi që i mundësojnë atyre qetësi mendore dhe financiare në rast dëmi.

Madje, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group Austria, përveçse ofron mbulim për çdo banesë apo biznes në çdo cep të vendit, ka paketa Sigurimi të personalizuar sipas risqeve që janë më evidente në zonën ku jetoni dhe ushtroni aktivitetin tuaj.

“Ndryshimet klimatike po shkaktojnë thatësira, intensifikimin e zjarreve dhe po nxit kushte atmosferike ekstreme me rrebeshe shiu dhe breshëri, përmbytje, stuhi ere etj.

Këto fenomene natyrore mund të shkatërrojnë shtëpi, makina, biznese dhe të mbjella, duke çuar këdo drejt një kolapsi financiar.

SIGAL UNIQA, edhe përmes mediave, ka apeluar në vazhdimësi tek qytetarët dhe bizneset që ti shohin siguracionet si e vetmja mundësi që çdo barrë financiare e ardhur nga të tilla ngjarje të kalojë te



kompania e sigurimit.

Duke qenë pjesë e një grupi të madh si “UNIQA Insurance Group” dhe bashkëpunues me kompanitë më të mëdha të risigurimit në botë, SIGAL UNIQA është tashmë një kompani e konsoliduar prej shumë vitesh tashmë, duke ofruar mbulime të caktuara, sipas problematikave klimatike të zonës ku jetoni apo zhvillonit aktivitetin tuaj.

Pra, çdo individ apo biznes, tashmë mund të personalizojë sigurimin e tij sipas nevojave për të qenë 100% i mbuluar në rast dëmi.

Dhe vlera që duhet paguar në vit për sigurimin e shtëpisë apo biznesit është shumë modeste, teksa nis nga vetëm 5,000 Lekë në vit”, thotë Ogert Shkrepa, Drejtor i Departamentit të Pasurisë dhe Garancive në SIGAL UNIQA.

“Kapriçiot” e natyrës mund të shkatërrojnë jo vetëm shtëpi dhe biznese, por edhe automjete.

Dhe dëmet nga fatkeqësitë natyrore për automjetet mbulohen vetëm nga Sigurimi KASKO.



“Sigurimi KASKO nga SIGAL UNIQA është i vetmi sigurim motorik vullnetar që mbulon edhe dëmet që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore, siç janë përmbytjet, stuhitë apo breshëri.

Por Sigurimi KASKO nga SIGAL UNIQA ju mbulon financiarisht dmet që mund të shkaktohen në parkim, dëmet nga zjarri, rrufeja ose shpërthimi, apo nga dëmtimet aksidentale.

Sigurimi KASKO nga SIGAL UNIQA ju mbulon edhe vjedhjen e pjeshme ose te plote te mjetit tuaj.

Te gjitha rrisqet e mësiperme te sigurimit Kasko mund të mbulohen edhe jashtë Shqipërisë. Për më tepër SIGAL UNIQA ofron edhe shërbimin e Asistencës Rrugore “AutoSOS” për drejtuesit e mjeteve në Shqipëri dhe në Europë, që është një risi për Shqipërinë dhe rajonin dhe që ofrohet vetëm nga kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe jo vetëm”, shprehet Besnik Çobaj, Drejtor i Departamentit Motorik në SIGAL UNIQA.

Të kesh një policë sigurimi kundër katastrofave natyrore është një mënyrë për të mbrojtur plotësisht asetet tuaja nga kostot e dëmtimeve dhe/ose humbjeve që mund të shkaktohen nga përmbytjet. Nëse nuk e keni një sigurim, çdo dëm në pronën tuaj do të paguhet nga xhepi juaj.

MOS HARRONI! Sigurimet e bënë individin shumë të fuqishëm dhe të pavarur. Sepse, ekzistenca e një kontrate sigurimi është shumë më e fuqishme se çdo kontratë tjetër.

E nënshkruar nga të dyja palët ajo gjithmonë do të japë zgjidhje, duke mos e detyruar qytetarin të endet zyrtare të institucioneve për të kërkuar ndihmë. Bota sot është kaq e zhvilluar, kaq e qytetëruar edhe për faktin se sigurimet kanë qenë gjithmonë mburoja e këtyre tregjeve, mburoja e të gjithë pasurive. Sepse janë tregjet e sigurimeve që rikthejnë çdo pasuri në gjendjen e mëparshme, pavarësisht vlerës që mund të ketë dëmi.

Mos e lini Shtëpinë, Biznesin apo Automjetin pas Siguracionin e nevojshëm.

SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku.

Kronika e Top News:

<https://www.youtube.com/watch?v=yS7zzqhzP2c>



Orkestra e Harqeve SIGAL UNIQA, koncert me rastin e 79-vjetorit të Çlirimit të Tiranës

Mëngjesin e 17 nëntorit të vitit 1944, pas 19 ditë e net luftë të ashpër e të pandërprerë, kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, u çlirua.

Operacioni mësymës për çlirimin e Tiranës u përgatit dhe u zhvillua në kuadrin e mësymjes së përgjithshme të UNÇSH-së për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Çlirimi i kryeqytetit pati rëndësi të madhe politike e ushtarake. Ai kurorëzoi fitoren e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ndërsa i shkaktoi humbje të mëdha e vonoi tërheqjen e forcave gjermane. Për të kremtuar këtë datë të rëndësishme historike dhe për të kujtuar në 100-vjetorin e saj të lindjes kompozitorin Dhora Leka, u organizua në ambjentet e Muzeut Historik Kombëtar një koncert, organizuar nga Qendra Kulturore e Forcave të Armatosura.

‘Qershia mbi tortë’ e të gjithë eventit ishte Orkestra e Harqeve SIGAL UNIQA, e cila solli për publikun këngë të njohura partizane, një pjesë e mirë e së cilave janë kompozuar nga vetë Dhora Leka.

Orkestra e Harqeve “SIGAL UNIQA”, e themeluar në vitin 2013 si ide dhe iniciativë e Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari, vijon të jetë pranë artdashësve përmes koncerteve të saj.

Ajo është e përbërë nga 15 instrumentistë dhe drejtohet nga dirigjenti Ermir Dizdari (Mjeshtër i Madh).

SIGAL UNIQA beson fort se arti në përgjithësi dhe muzika në veçanti rikthen shpresën te njerëzit ndaj prej vitesh, përmes Orkestrës së saj të Harqeve, ka dhënë me dhjetëra koncerte në thuajse të gjitha qytetet e Shqipërisë, Vlorë, Elbasan, Durrës, Pogradec, Butrint, Shkodër, Lezhë, Valbonë etj. Ndërsa nuk ka munguar as në aktivitete jashtë vendit.



SIGAL Audiobooks.al iu ribashkua Panairit të 26-të të Librit



Në mjediset e Pallatit të Kongreseve në Tiranë, nga data 15-19 nëntor, do të mbahet Panairi i 26 i Librit, një ngjarje mbarëkombëtare e kulturës që pritet me shumë interes.

Panairi i përvitshëm i librit mbledh bashkë shtëpitë botuese nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, shkrimtarë, poetë, përkthyes dhe lexues, ku njihen me botimet e reja, diskutojnë mbi problematikat e letërsisë bashkëkohore, përkthimit në gjuhën shqipe dhe shumë aktivitete të tjera me të autorë dhe studiues.

Por këtë vit, panairit i ribashkohet edhe e vetmja “Librari Digjitale” në Shqipëri, “SIGAL Audiobooks”.

Platforma e parë dixhitale e librave audio në shqip, e cila sjell te shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve pa asnjë kosto, librat e autorëve më të njohur vendas dhe të huaj, do të jetë për 5 ditë rresht me stendën e saj në panair ku çdo vizitor do të ketë mundësinë të njihet nga afër se çfarë është kjo platformë, çfarë ofron, si mund të përdoret dhe të testojnë live aplikacionin.

Për shkak edhe të zhvillimeve teknologjike dhe jo vetëm, Audiobooks-et janë një formë shumë efiçente për ta sjellë librin, informacionin, kulturën edhe tek ata që mbase nuk e kanë kohën të shfletojnë një libër fizik. Ndaj, mos harroni! Përgjatë pesë ditëve, nga 15 deri më 19 nëntor, “SIGAL Audiobooks” ju mirëpret ta vizitoni në “Panairin e Librit”, në Pallatin e Kongreseve.

“SIGAL AudioBooks, merreni Librarinë kudo me vete”

Aktualisht në “SIGAL Audiobooks.al” gjenden mbi 300 libra dhe informacione mbi sigurimet, të gjitha të disponueshme dhe të aksesueshme online për të gjithë. Ndërsa janë mbi 50 mijë përdorues, të cilët në çdo moment mund të dëgjojnë falas, nga celulari ose kompjuteri, titujt që dëshirojnë.

Në “Audiobooks.al” e gjejnë veten duke filluar që nga fëmijët e moshave të vogla, duke dëgjuar përrallat e tyre të preferuara, fëmijët pak më të rritur me librat shkollorë apo libra artistikë që u përshtaten moshës së tyre dhe deri tek të rriturit, që mund të dëgjojnë romane, histori, kulturë, e plot libra interesante dhe me vlera të mëdha.

Librat vijnë tek përdoruesit nëpërmjet zërave të njohur të personazheve që kanë shumë vite eksperiencë në gazetari dhe jetën publike, dhe me profesionalizmin dhe zërin e tyre unik përcjellin tek çdo dëgjues librat më të mirë të epokës moderne, si dhe të historisë e kulturës së vjetër mesjetare e të Rilindjes. Mjafton të shkarkoni aplikacionin në App Store ose Play Store për të dëgjuar kudo dhe kurdo librat që dëshironi.

Regjistrimi është shumë i thjeshtë. Shkoni te pjesa “Login” dhe me vetëm një adresë e-maili mund të jeni një prej mijëra përdoruesve.

Bli
Online

Më shumë kujdes për familjen tuaj

Karta e Kujdesit Shëndetësor nga SIGAL UNIQA



Vetëm 1 në 35 mijë ka një pension privat

Ponari: Do të duhej të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues



Vetëm një në 35 mijë të punësuar në vend derdh diçka nga rroga e vetë në skemat private të pensioneve.

Të dhënat tregojnë se nga mbi 1.3 milionë të punësuar, numri i kontribuuesve vullnetarë në fund të shtatorit ishte 38,001. Tënë ndryshe 2.9% e totalit.

“Do të duhej në fakt që ne të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues. Jemi në nivele shumë të ulëta. Duhet menduar si diçka e nevojshme, veçanërisht për ata që duan të jetojnë me dinjitet“, thotë për A2 CNN Elvis Ponari, CEO i “SIGAL Pension” dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Jetës dhe Pensioneve.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se nga dhjetori i shkuar e deri në shtator të këtij viti, numri i kontribuuesve u rrit me vetëm 1,483 individë të rinj.

Thënë ndryshe, skemës iu shtuan çdo muaj, rreth 210 vetë.

Vetëm një në 35 mijë të punësuar në vend derdh diçka nga rroga e vetë në skemat private të pensioneve.

Të dhënat tregojnë se nga mbi 1.3 milionë të punësuar, numri i kontribuuesve vullnetarë në fund të shtatorit ishte 38,001. Tënë ndryshe 2.9% e totalit.

“Do të duhej në fakt që ne të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues. Jemi në nivele shumë të ulëta. Duhet menduar si diçka e nevojshme, veçanërisht për ata që duan të jetojnë me dinjitet“, thotë për A2 CNN Elvis Ponari, CEO i “SIGAL Pension” dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Jetës dhe Pensioneve.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se nga dhjetori i shkuar e deri në shtator të këtij viti, numri i kontribuuesve u rrit me vetëm 1,483 individë të rinj.

Thënë ndryshe, skemës iu shtuan çdo muaj, rreth 210 vetë.



Për një shtëpi më të sigurt për familjen tuaj

Sigurimi i Pronës nga SIGAL UNIQA

Bli
Online



- Jo thjesht një kompani sigurimesh

‘UNIQA’ vijon traditën, dorëzon çekun për “Caritas Austria”



Që prej vitit 1989, “Caritas Hospice” u ka mundësuar njerëzve të sëmurë dhe atyre në nevojë një strehë ku mund të kalojnë kalojnë ditët e tyre të fundit në mënyrë të ngrohtë dhe të sigurt.

Punonjësit e qendrës dhe vullnetarët e tyre janë një mbështetje e fuqishme jo vetëm për ta, por edhe për amiljarët e tyre. Por që nuk duhen anashkaluar donatorët dhe ndihma e vazhdueshme, edhe monetare, që ata japin.

“Raiffeisen Bank International AG” dhe “UNIQA” kanë mbështetur “Caritas Austria” që prej vitit 2004.

Këtë vit ishin Drejtori i Përgjithshëm i RBI, Johann Strobl dhe anëtari i bordit të UNIQA, René Knapp, që i dorëzuan Klaus Schwertner, Drejtorit të Caritas-it në Kryedioqezën e Vjenës, çekun e përbashkët prej 70,000 eurosh.

“Kujdesi për qendrën po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Punonjësit e “Hospice Caritas” bëjnë një punë të pallogaritshme për t’ju dhënë

pacientëve me sëmundje terminale dhe familjeve të tyre mbështetje që u nevojitet. Jemi të kënaqur që, së bashku me RBI-në, kemi mundur të japim një kontribut në ruajtjen e këtij shërbimi thelbësor për gati dy dekada“, është shprehur René Knapp.

“KUSH ËSHTË “UNIQA INSURANCE GROUP”?

“UNIQA Insurance Group” daton prej vitit të largët 1811 kur u themelua “Salzburger Landes-Versicherung”.

Ndërsa sot, kompania mban emrin e saj në rangun e lartë të industrisë së sigurimeve, me një shtrirje në 17 shtete ku operon përmes 40 kompanive.

UNIQA ofron të gjitha kategoritë e sigurimit, ndërsa produktet e saj shkojnë tek klienti përmes marketingut ekskluziv, ndërmjetësve, agjencive të përgjithshme dhe shitjeve online.

Sipas studimeve të pavarura, “UNIQA Insurance Group” është prej shumë vitesh marka më e njohur dhe më e besueshme e sigurimeve në Austri.

Ajo numëron rreth 22,400 punonjës dhe mbi 16 milionë klientë

“UNIQA Insurance Group”, i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve

“UNIQA Insurance Group” ishte i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve.

Që prej 23 mars 2007, kompania austriake zotëron rreth 87% të aksioneve të kompanisë së parë shqiptare të sigurimeve, SIGAL.

SIGAL UNIQA, pikërisht përmes “UNIQA Insurance Group”, solli për herë të parë në Shqipëri Sigurimin Privat të Shëndetit ndërsa sot, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, me mbi 1,2 milion klientë, ofron shërbime inovatore për vendin dhe jo vetëm siç janë “TeleShëndet”, “Jetë Plus”, “Sigurimi anti Tumor”, “Check Up sipas Protokollit japonez” apo “SIGAL UNIQA AutoSOS”, paketa sigurimi dhe shërbime me benefite dhe me mbulime brenda e jashtë Shqipërisë, si asnjë kompani tjetër sigurimi.



SIGAL
UNIQA GROUP AUSTRIA



**PAKETA
FESTIVE**

Dhuroni SIGURI

PËR FESTA

Për vetëm
18.000
lekë/vit

